VENDIM
Nr.726, datë 1.9.2010

PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për:

a) inspektimin e punonjësve civilë, për zbatimin e legjislacionit të punës;

b) dërgimin e të dhënave, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për aksidentet në punë me pasojë vdekjen ose jo, si edhe për sëmundjet profesionale.

2. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Institutin e Mjekësisë Ligjore për vënien në dispozicion të një kopjeje të procesverbalit që mbahet nga mjekësia ligjore për të evidentuar shkakun e aksidentit në punë.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha